

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-214/13

Prishtinë,

17 shtator 2014

Në çështjen juridike të:

N. A.

Viti

Pala ankuese

kundër

L. S. M.

Niș

Serbia

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Esma Erterzi, C Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe , gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/126/2011 të datës 26 tetor 2011 (lëndët janë të regjistruara me numrat KPA34614, KPA34615, KPA34616, KPA34617, KPA34618, KPA34619, KPA34621, KPA34622 dhe KPA34623), pas shqyrtimit të mbajtur më 17 shtator 2014, mori këtë

AKTGJYKIM:

1. Lëndët GSK-KPA-A-214/13, GSK-KPA-A-215/13, GSK-KPA-A-216, GSK-KPA-A-217/13, GSK-KPA-A-218/13, GSK-KPA-A-219/13, GSK-KPA-A-220/13, GSK-KPA-A-221/13 dhe GSK-KPA-A-222/13 janë bashkuar nën një lëndë të vetme të regjistruar me numër GSK-KPA-A-214/13.
2. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. A. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/126/2011 të datës 26 tetor 2011, lidhur më lëndën në AKP me numrat KPA34614, KPA34615, KPA34616, KPA34617, KPA34618, KPA34619, KPA34621, KPA34622 dhe KPA34623.
3. Vërtetohet vendimi i KKPK-së KPCC/D/A/126/2011 i datës 26 tetor 2011, lidhur më lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA34614, KPA34615, KPA34616, KPA34617, KPA34618, KPA34619, KPA34621, KPA34622 KPA34623.

Përmbledhja e çështjeve procedural dhe faktike:

1. Më 30 nëntor 2007, L. S. M. ka paraqitur nëntë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së saj pronësore dhe ri-posedimin e disa pronave në një ngastër toke në Viti. Kërkesat janë regjistruar si nëntë kërkesa nga AKP-ja. Hollësitë rreth numrave të lëndëve në AKP dhe në Gjykatën Supreme, si dhe informatat lidhur me pronat, janë paraqitur më poshtë:

Lënda nr. GSK- KPA-A	Kërkesa nr.	Ngastra nr.	Kadastru nr.	Sipërfaqe	Fshati Vendi	Sipas
214/13	KPA34614	171	70101033	1 721 m ²	Pozharan Strnjaca	Certifikatës të datës 26.02.2013
215/13	KPA34615	204	70101033	3 542 m ²	Pozharan Strnjaca	Certifikatës të datës 26.02.2013
216/13	KPA34616	206	70101033	3 633 m ²	Pozharan	Certifikatës të datës 26.02.2013

217/13	KPA34617	836	70101033	1 016 m2	Pozharan Fshat Oborr	Certifikatës të datës 26.02.2013
218/13	KPA34618	969	70101033	13 065 m2	Pozharan Potok	Certifikatës të datës 26.02.2013
219/13	KPA34619	971	70101033	12 297 m2	Pozharan Potok	Certifikatës të datës 26.02.2013
220/13	KPA34621	4		6 910 m2	Çiflak	
221/13	KPA34622	7		2 263 m2	Çiflak	
222/13	KPA34623	8		19 637 m2	Çiflak	

2. Certifikata e datës 26 shkurt 2013 është lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Vitisë. Për lëndët nr. 220 – 222, nuk është dorëzuar ndonjë certifikatë apo Fletë Posedimi e lëshuar nga Autoritetet Kosovare. Nga certifikata e datës 26 shkurt 2013 rrjedh se Božidar Stošić ishte i regjistruar si pronar i 1/3 të pjesës ideale të pronave të përmendura në certifikatë.
3. Së bashku me kërkesat, L. S. M. ka dorëzuar *inter alia*:
 - Certifikatën e lindjes të datës 23 gusht 2004 që tregon se ajo është e bija e B. S.;
 - Certifikatën e vdekjes që tregon se B.S. ka vdekur më 26 shkurt 2002;
 - Vendimin për trashëgimi T.nr. 401/02 i dhënë nga Gjykata Komunale në Jagodinë të datës 23 shtator 2002, që tregon se L.S. M.ka trashëguar 1/2 të pjesës ideale nga e tërë trashëgimia. Pronat e kërkuara janë përmendur të gjitha në vendim. Gjysmën tjetër të trashëgimisë e ka trashëguar motra e saj S. Dj.
4. Tre dokumentet e cekura më lartë janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
5. Më 23 tetor 2008, me vendimin grupor KPCC/D/A/25/2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) miratoi kërkesat e bëra në të gjitha nëntë lëndët e përshkruara më lartë.
6. Megjithatë, vendimi është anuluar me vendimin nr. KPCC/RES/15/2010 të datës 19 shkurt 2010. Sipas rezolutës, kërkesat nuk kishin qenë identifikuar fizikisht apo njoftuar si duhet. Njoftimet fizike ishin bërë në lokacionet e gabuara.

7. Më 26 tetor 2011, me vendimin grupor KPCC/D/A/126/2011, KKPK përsëri miratoi kërkesat e bëra në të gjitha nëntë lëndët.
8. Vendimi i rimarrë ishte bërë pa njoftim fizik të nëntë pronave. Megjithatë, nga “Raporti i Njoftimit dhe Konfirmimit” i datës 25 gusht 2010, rrjedh se njoftimi i kërkesave ishte bërë në Gazetën për Njoftime të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-së për Çështje Pronësore. Përveç kësaj, një kopje e njoftimit të kërkesave KPA34614-34616, KPA34619 dhe KPA34219-221 është lënë të pronari i shitores “Sameti”, një njoftim i kërkesës KPA34617 është lënë te pronari i shitores “Shansa”, dhe një kopje e kërkesave në lëndët KPA34621-34623 është lënë te një punëtor shkolle në shkollën fillore “Halil Alidema”.
9. Vendimi grupor i datës 26 tetor 2011 i është dorëzuar L. S. M. më 8 qershor 2012.
10. Më 12 korrik 2013, Nehat Alidema ka paraqitur ankesë kundër vendimit grupor për të nëntë lëndët. Ankesa i është dorëzuar L. S. M. më 12 tetor 2013. M. ka paraqitur përgjigjen ndaj ankesës më 12 nëntor 2013. Gjykata Supreme shkresat e lëndës i ka pranuar më 6 mars 2013.

Pretendimet e palëve

11. N. A. ka deklaruar përgjithësisht se vendimi grupor i KKPK-së përmban gabime thelbësore apo zbatim të gabuar të së drejtës procedurale dhe së drejtës materiale në fuqi. A. e ndërlihd këtë me mungesën e dokumenteve në KKPK. Ai ka dorëzuar dokumentet vijuese së bashku me ankesën.
 - Kontratën e shitjes të datës 11 korrik (viti nuk dihet).
 - Autorizimin nga S. Dj. për N. A. (pa datë) më vërtetim të nënshkrimit nga Gjykata Komunale e Cuprija të datës 8 tetor 2004. Autorizimi e autorizon A. që t'i shes ngastrat nr. 4 të regjistruara në Fletën Poseduese 98, dhe ngastrat 969/1, 971/2 dhe 204, të gjitha të regjistruara në Fletën Poseduese 289.
 - Autorizimin nga B. S. për S. M. T. e datës 1 shkurt 2001, me vërtetim të nënshkrimit nga Gjykata Komunale e Cacak të së njëjtës datë. Në autorizim thuhet se T. “mund që, në përputhje me vendimin e gjykatës për pronësinë mbi pronën e paluajtshme private të regjistruar në fletën poseduese nr. 98 CM Ciflak, vendi i quajtur “Adzin grob”, me sipërfaqe prej 2 hektarësh dhe 19 ari, si dhe 2/3 të mijat të pronës së paluajtshme të regjistruar në fletën poseduese nr. 289CM Pozaranje,

- Procesverbalet
 - Faturat
 - Numrat e bankënotave
 - Letërnjoftim
12. Në lëndën 214/13 dhe në lëndët 216/13 deri 222/13, A. ka deklaruar se ai nuk e ka paraqitur ankesën me kohë sepse nuk ka qenë i njoftuar për kërkesën, dhe deklaroi se L. S.M. ka problem me familjen e vet, jo me A.
13. Në lëndën 215/13, A. ka deklaruar se ai e ka blerë ngastrën nr. 171 nga S. S.
14. L. S. M. pretendon se ankesat nga A. duhet të hidhen poshtë sepse A. nuk ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së, dhe për shkak se ankesat janë të paafatshme për rreth një vit.
15. Sa i përket meritave, M. pretendon se babai i saj, B. S., kurrë nuk e ka dhënë autorizimin që është dorëzuar. Autorizimi është i falsifikuar. B. S. kurrë nuk ka qenë në Cacak, dhe numri i letërnjoftimit të paraqitur në Gjykatën Komunale në Cacak është 12381, ndërsa numri i letërnjoftimit të lëshuar më 3 mars 1997 nga FPD Viti është 67227.

Bashkimi i lëndëve

16. N. A. ka paraqitur ankesa kundër vendimit të KKPK-së për lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA34614, KPA34615, KPA34616, KPA34617, KPA34618, KPA34619, KPA34621, KPA34622 dhe KPA34623. Lëndët janë paraqitur në Gjykatën Supreme me numra të lëndëve GSK-KPA-A-214/13, GSK-KPA-A-215/13, GSK-KPA-A-216/13, GSK-KPA-A-217/13, GSK-KPA-A-218/13, GSK-KPA-A-219/13, GSK-KPA-A-220/13, GSK-KPA-A-221/13 dhe GSK-KPA-A-222/13. Lëndët janë ndërmjet palëve të njëjta dhe për çështjet e njëjta; vetëm numrat kadastral janë të ndryshëm. Bashkimi i lëndëve do të kontribuojë në ekonomizimin e procedurës.
17. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes kësaj jep urdhurin për bashkimin e lëndëve nën numrin GJK-KPA-A-214/13 në përputhje me Ligjin për Procedurën Kontestimore, neni 408.1 dhe neni 193, që zbatohen *mutatis mutandis* sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Arsyetimi ligjor18. *Pranueshmëria e ankesës*

19. Ankesa është e pranueshme ndonëse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKKP-së. Kjo rrethanë nuk mund t' shkojë në dëm të palës ankuese pasi që në të vërtetë ai nuk kishte qenë i njoftuar si duhet për kërkesën. Njoftimi ishte bërë me anë të publikimit të kërkesës në Gazetën për Njoftime të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-së. Megjithatë, sipas jurisprudencës së Gjykatës Supreme, *inter alia* në GSK-KPA-A-130/12, kjo përbën “përpjekje të arsyeshme” për ta bërë njoftimin e kërkesës siç kërkohet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (*në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079*) vetëm në rastet e veçanta. Një përjashtim i tillë nuk mund të gjendet në këtë lëndë. Pasi që Gjykata nuk mund ta përjashtojë faktin se N. A. nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë, dhe ankesa e tij është e pranueshme.

Meritat e ankesës

20. N. A. ka paraqitur një kontratë të shitjes së pronës së paluajtshme të datës 11 korrik, viti nuk dihet. Sipas kësaj kontrate, B. S. i ka shitur ngastrat nr. 171, 836, 971/2, të regjistruara në fletën poseduese 289.

21. Megjithatë, kontrata e cekur nuk i jep N. A. ndonjë mbështetje për ankesën e tij.

22. Së pari, në kontratë fillimisht thuhet se B. S. përfaqësohet nga S. S. me autorizimin nr. 132/2001. Ndërsa S. S. ia ka dhënë autorizimin N. A. Megjithatë, në këtë autorizim të pretenduar, S. S. nuk është personi i autorizuar. Personi i autorizuar është N. A. Duket e mundshme se N. A. dhe N. A. janë personi i njëjtë, por mungesa e koherencës ndërmjet autorizimit dhe kontratës nuk i shton besueshmëri dokumenteve.

23. Së dyti, sipas kontratës së dorëzuar, N.A. nuk është blerësi, por vepron si “Personi i autorizuar i shitësit”. Blerësi i pretenduar është V. A. Rrjedhimisht, kontrata nuk i jep N. A. ndonjë të drejtë mbi ndonjë pronë.

24. Së treti, kur nënshkrimi i autorizimit VR.nr.132/2011 të pretenduar është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Cacak, vërtetimi ka qenë i bazuar në letërnjoftimin me numër. 12381, ndërsa letërnjoftimi i lëshuar nga autoritetet në Viti, ku B. S. jetonte, e ka numrin 67227. Autorizimi i sipërpërmendur nuk është vërtetuar nga ana e Njesisë së Verifikimit të AKP-ës.
25. Së fundmi, Gjykata Supreme konstaton se A. ka dorëzuar vetëm dokumentet që mund të ndërliidhen me tri lëndët: Lënda 214/13 (ngastra nr. 171), 217/13 (Ngastra nr. 836) dhe 219/13 (ngastra nr. 971). Për lëndët tjera nuk janë dorëzuar prova të ndonjë rëndësie.
26. Si konkludim, N. A. nuk ka arritur të paraqes prova se ai është pronar i ndonjërës prej ngastrave të shqyrtuara në nëntë ankesat. Nga pikëpamja e të lartcekurave, në përputhje me nenin 13.3 pika (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

27. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esmat Erterzi, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer Referent i EULEX-it